

Hapet Thirrja për Bursa në Programin Erasmus + në Universitetin Eberswalde, Gjermani për vitin akademik 2017-2018

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në Universitetin Eberswalde, në kuadër të programit Erasmus + të Komisionit European, për studentët e nivelit Bachelor dhe Master të UT-ës.

Llojet e mobilitetit përfshijnë:

- Shkëmbimin e studentëve për studime;

Nivelet e mobilitetit për studentët:

- **Bachelor** (studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Bachelor në Universitetin e Tiranës. Nuk mund të aplikojnë dot studentët e regjistruar në vitin e parë dhe studentët e regjistruar në vitin e tretë);
- **Master** (studentët duhet të jenë të regjistruar në një program studimi Master në Universitetin e Tiranës. Nuk mund të aplikojnë dot studentët e regjistruar në vitin e dytë);

Fushat e shkëmbimit:

- International Forest Ecosystem Management, për studentët e nivelit Bachelor;
- Forest Information Technology, për studentët e nivelit Master;

Katalogu i studimeve:

<http://www.hnee.de/en/Faculties/Faculty-of-Forest-and-Environment/Study-programmes/Study-Programmes-K1274.htm>

Kohëzagjatja e bursave:

- Studentët e nivelit Bachelor mund të aplikojnë për semestrin e parë ose për të gjithë vitin akademik 2017-2018.
- Studentët e nivelit Master mund të aplikojnë për semestrin e parë të vitit akademik 2017-2018.

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor (850 EUR në muaj)
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)	Kompensimi
Midis 100 dhe 499 KM	180 EUR
Midis 500 dhe 1999 KM	275 EUR
Midis 2000 dhe 2999 KM	360 EUR
Midis 3000 dhe 3999 KM	530 EUR
Midis 4000 dhe 7999 KM	820 EUR
8000 KM ose më shumë	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Studentët që përfitojnë nga mobiliteti Erasmus + nuk do të paguajnë asnjë tarifë për shkollim në universitetin pritës. Studentët do të vazhdojnë të paguajnë shkollimin e tyre dhe/ose tarifat e regjistrimit në universitetin e tyre të origjinës.

Procedura e Aplikimit dhe Dokumentat e nevojshme për aplikim:

Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Bachelor**:

- Foto pasaporte;
- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash Bachelor (duhet të përkthehet në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

- Letër Motivimi në gjuhën angleze;
- Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B2);
- *Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Eberswalde lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohenit në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvilloni/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel departamenti** dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

*Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf*

Dokumentet e nevojshme për aplikim për studentët e nivelit **Master**:

- Foto pasaporte;
- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Diplomë e nivelit Bachelor;
- Listë notash e nivelit Bachelor (duhet të përkthehet në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

-Listë notash e nivelit Master (duhet të përkthehet në mënyrë zyrtare në gjuhën angleze);

-Letër Motivimi në gjuhën angleze;

-Certifikatë e gjuhës së huaj (Anglisht B2);

-*Learning Agreement;

**Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvilloni në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the Mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin e Tiranës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Eberswalde lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin e parë, atëherë kur të ktheheni duhet të zhvillonit/frekuentoni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin e Tiranës.

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, më pas nga koordinatori akademik në nivel departamenti** dhe në fund në Rektorat nga Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.*

Për të shkarkuar formatin e Learning Agreement klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Learning_Agreement.pdf

Afati për aplikim: 17 Maj 2017

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin iro@unitir.edu.al me subjekt, emrin dhe mbiemrin tuaj si dhe universitetin në të cilin po aplikon.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!